


REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD U PRIŠTINI

DEGA NË LIPJAN – OGRANAK LIPLJANE

Rexh.nr.4191/2012

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË LIPJAN, DEPARTAMENTI PËR KUNDERVAJTJE, sipas gjyqtarit Rrustem Begolli duke vendosur ne proceduren kundervajtese kunder te pandehurit: Fitim Rahim Selimi per vepër kundrevajtëse te kryer nga neni 5.6 paragrafi 1.3 dhe neni 9 të ligjit nr.04/L-050 për deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar , si dhe ne mbeshtetje te neneve 73,74 , 195 dhe te LMK, me daten 18.10.2013 bjen kete:

A K T V E N D I M

PEZULLOHET PROCEDURA KUNDËRVAJTËSE ndaj të pandehurit Fitim Rahim Selimi në bazë të nenit 198.al.l.pk.8. të Ligjit mbi kundërvajtjet, me që nuk ka prova se i pandehuri ka kryer veper te kundervajtjes nga neni neni 5.6 paragrafi 1.3 dhe neni 9 të ligjit nr.04/L-050 për deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar.

Me nga një kopje të këtij aktvendimi do të njoftohet i pandehuri dhe paraqitësi i kërkeses.

A r s y e t i m

Agjencia kundër korupcionit ka paraqitur kërkesen nr.01-2197/2012 me datën 04.06.2012, dhe ka kerkuar qe te zhvillohet procedura kundervajtese, kunder te pandehurit **Fitim Rahim Selimi** per veprën kundervajtëse si më lartë.

Me iniciimin e procedures , pas leximit të shkresave të lëndes per vertetimin e gjendjes faktike gjykata ka ftuar te pandehurin ne mbojtje dhe gjate mbrojtjes se tij ka mohuar veprën kundervajtese duke deklaruar ‘Se veprën për të cilën po ngarkohet e ka kuptuar në tërësi, por ka deklaruar se nga zyrtarët komunal nuk jam njoftuar zyrtarishte dhe nuk kam pranar zyrtarisht asnji aplikacion, por nuk jam njoftuar as gojarisht se në qoftëse me rastin e emrimit si këshilltar komunal , jam I obliguar që të bëjë deklarimin e pasurisë pranë këtij agjencioni. Ka kerkuar që nga gjykata që ta shpall të pafajshëm lidhur me këtë vepër kundervajtëse’.

Lidhur me këtë qështje kundervajtëse është marë në pyetje edhe Enis Sadiku në cilësi të perfaqsesit të agjencisë për anti-korupcion i cili ka deklaruar: Mbetem pranë kërkesës për iniciimin e procedurës kundervajtëse ndaj të pandehurit Fitim Selimi. Ka deklaruar se sipas ligjit të ri i cili ka hyrë në fuqi në shtator të vitit 2011 për herë të parë me këtë ligj janë obliguar edhe asambleistët të bëjnë deklarimin e pasurisë së tyre, andaj në shkurtë të vitit 2012 kemi bërë trajnimin e të gjithë zyrtarëve kontaktues të cilit janë nepër Komuna. Normalishtë në Komunën e Lipjanit zyrtari

03-3590/13/02
fug

kontaktues ka qenë i obliguar që ta përgadis listën dhe ta dorzoj në agjencionin për personat të cilit janë të obliguar ta deklarojnë pasurinë. Sipas ligjit gjdo zyrtar është i obliguar që pasurinë ta deklaroj nga data 01.03.2012 deri me datën 31.03.2012 domethënë është obligim ligjor i deklarimit të pasurisë, dhe pas këtij afati zyrtari mund ta deklaroj por inicohet procedurë për vones. Dhe në bazë të kësaj liste e cila është si provë në shkresat e lëndës kemi dorzuar listën dhe ne kemi dhënë disa menyra-propozime që zyrtarët kontaktues të kontaktoj me personat të cilit janë të obliguar ta deklarojnë pasurinë të njoftohen përmes telefonit përmes e-maillave apo listën ku nenshkruhet zyrtarët komunal. Ka kërkuar që ky i pandehur të shpallet fajtor për këtë veprë kundervajtëse, dhe për vertetimin e gjendjes faktike të marë në pyetje edhe zyrtarët komunal të cilit kan pasur për obligim që të bëjë njoftimin të KK Lipjanit.

Kjo gjykatë e ka marr edhe deklaratën e Sami Bytyqit në cilësi të deshmitarit i cili ka qenë personi kontaktues për informimin e asambleistëve në KK të Lipjanit lidhur me obligimin e deklarimit të pasurisë i cili ka deklaruar: Dua të deklaroj se është e vertet se kam qenë personi përgjegjës në Komunën e Lipjanit i cili kam pasur për obligim që të njoftoj personat të cilit kanë për obligim deklarimin e pasurisë pranë KK Lipjan për agjencinë e antikorrupsionit. Dua të theksoj se njoftimin e deputetëve për obligimin e deklarimit të pasurisë **nuk e kam bërë unë**, por kam shkuar te kryesusi i kuvendit komunal i cili gojarishtë e ka marë përgjegjësinë që të bëjë njoftimit e deputetëve që ta bëjnë deklarimin e pasurisë me të cilin kam biseduar dhe i cili është i gatshëm që të vjen të jap deklaratë pranë kësaj gjykate.

Gjyqtari duke u bazuar në shkresat e lëndës, deklaratën e te pandehurit e sidomos në deklaratën e deshmitarit Sami Bytyqi të cilit ia falë besimin e plotë, ka vertetuar në bazë të bindjes së lire se në veprimet e të pandehurit Fitim Rahim Selimi nuk egzistojnë elementet e veprës kundervajtëse e cila i vëhet në barë konformë nenit 5.6 paragrafi 1.3 dhe neni 9 të ligjit nr.04/L-050 për deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, me që nuk është vertetuar se i pandehuri ka kryer veprën kundervajtëse për të cilën po ngarkohet, ndaj të cilit pezullohet procedura kundervajtëse konformë nenit 198 alinea 1 pika 8 të LMK-se me që nuk ka prova se i pandehuri ka kryer veprë të kundervajtjes.

Mbi të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kunder këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë Gjykatës së Apelit në Prishtinë divizionit për kundervajtje në afat prej 8 dite nga dita e marrjes së të njejtit, në përmes kësaj gjykate pa taksë.



Gjyqtari
Rrustem Begolli

R. Begolli